

**IKShPK-ja: Vaksina
mbetet mënyra
më e sigurt për
parandalimin e fruthit**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OPOZITA KUNDËRSHTON SHTRENJTIMIN E ÇMIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

F. 4-5



Nga 1 prilli i këtij viti çmimi i energjisë elektrike në Kosovë do të rritet 15 % më shumë. Kryetari i Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRë) ka thënë se nëse më herët kemi paguar 50 euro,

tani do të paguajmë 58 euro. Partitë opozitare kanë thënë se zbatimi i vendimit të ZRRë-së do të ketë pasoja të rënda për ekonominë e vendit dhe për mirëqenien e qytetarëve. Sipas tyre, rritja e

çmimit të energjisë është goditja e parë, por jo e fundit, sepse kur bizneseve u rriten shpenzimet, atëherë çmimet e të gjitha produkteve bazë do të rriten përsëri

**ÇFARË PËRMBAN
DEKLARATA PËR
BASHKËPUNIM
USHTARAK NË MES TË
KOSOVËS, SHQIPËRISË
DHE KROACISË?**

F. 3



**STAGNIMI NË DIALOG
SPROVON BE-në**

F. 7



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË



**KOSOVA SHKRUAN HISTORI,
NGRITËT NË LIGËN B**

F. 6

SPORT

**SHTRENJTIMI I ENERGJISË,
PARALAJMËROHET RRIJTJE
E ÇMIMIT TË QUMËSHITIT**

F. 7

**SHPENZIMET E BUXHETIT
2024, KU SHKUAN MBI
3 MILIARDË EURO?**

F. 7



EKONOMI

**PAPA FRANÇESKU LIROHET
NGA SPITALI**

F. 2

**EMISARI AMERIKAN, OPTIMIST PËR
BISEDIMET PËR UKRAINËN, THOTË
SE PUTINI "DËSHIRON PAQE"**

F. 2



AKTUALE

Emisari amerikan, optimist për bisedimet për Ukrainën, thotë se Putini “dëshiron paqe”

WASHINGTON, 23 MARS - I dërguari i posaçëm amerikan, Steve Witkoff, ka shprehur optimizëm më 23 mars, para takimit të nivelit të lartë në Arabinë Saudite, që synon t'i japë fund luftës në Ukrainë. Ai ka thënë tha se ai beson që presidenti rus Vladimir Putin dëshiron t'i japë fund konfliktit trevjeçar. “E ndiej se ai dëshiron paqe”, tha Witkoff për “Fox News”.

Delegacioni amerikan pritet që më vonë gjatë së dielës të takohet me zyrtarët ukrainas në Arabinë Saudite për mundësinë e një armëpushimi të pjesshëm në mes të Ukrainës dhe Rusisë. Zyrtarët amerikanë dhe rusë

më pas të hënën do të takohen, po ashtu, në Arabinë Saudite. “Mendoj se të hënën në Arabinë Saudite do të shohim përparim të vërtetë, veçmas pasi kjo prek armëpushimin ndaj anijeve të dy shteteve në Detin e Zi. Dhe duke nisur nga kjo, ne do të shkojmë drejt një armëpushimi të plotë”, tha Witkoff.

Javën e kaluar Putini u pajtua për ndërprerjen e përkohshme të sulmeve ndaj infrastrukturës të energjisë së Ukrainës, por nuk pranoi të mbështeste një armëpushim të përgjithshëm 30-ditor që presidenti amerikan Donald Trump shpresonte të ishte hapi i parë

drejt një marrëveshjeje të përhershme të paqes.

Ukraina e ka pranuar propozimin e Trumpit për armëpushim 30-ditor.

I pyetur lidhur me kritikën perëndimore ndaj Putinit, Witkoff tha se ai beson se ka dy anë të medaljes në çdo situatë dhe minimizoi shqetësimet e aleatëve të Uashingtonit në NATO se Moska mund të inkurajohet nga një marrëveshje dhe të pushtojë fqinj të tjerë. “Thjesht, nuk shoh se ai dëshiron ta marrë të gjithë Evropën. Kjo është një situatë shumë ndryshe nga ajo e Luftës së Dytë Botërore”, tha Witkoff.



Presidenti amerikan Donald Trump e ka kthyer në prioritet kryesor përfundimin e luftës që Rusia nisi kundër Ukrainës

më 2022. Konflikti ka vrarë dhe plagosur mbi një milion persona.

Gjykata turke urdhëron burgosjen e Imamoglut

ANKARA, 23 MARS - Një gjykatë zyrtarisht e ka arrestuar kryetarin e Stambollit dhe rivalin kyç të presidentit Recep Tayyip Erdogan më 23 mars dhe e ka urdhëruar atë të dërgohet në burg deri në përfundimin e gjykimit lidhur me akuzat për korrupsion.

Kryetari i Stambollit, Ekrem Imamoglu, ishte ndaluar pas një bastisjeje në shtëpinë e tij më herët gjatë javës, duke nxitur valën më të madhe të protestave në Turqi për më shumë se një dekadë. Arrestimi i tij ka thelluar shqetësimet lidhur me demokracinë dhe sundimin e ligjit në Turqi.

Burgosja e tij gjerësisht shihet si lëvizje politike për të larguar një kundërshtar kyç nga gara e ardhshme presidenciale, që aktualisht është caktuar që të mbahet më 2028.

Zyrtarët qeveritarë kanë mohuar akuzat se veprimet ligjore ndaj figurave opozitare janë të motivuara politikisht dhe kanë insistuar se gjykatat e Turqisë veprojnë në mënyrë të pavarur.



Arrestimi zyrtar vjen pasi partia e tij opozitare, Partia Popullore Republikane (CHP), nisi t'i mbajë zgjedhjet e brendshme për ta zgjedhur kandidatin për president, me qëllim që ta mbështesë Imamoglut për këtë post, pavarësisht prej arrestimit të

tij. Kjo parti ka vendosur në mbarë vendin kuti simbolike të votimit - duke i quajtur “kuti të solidaritetit” - dhe duke lejuar qytetarët, që nuk janë anëtarë të partisë, që ta shprehin mbështetjen e tyre për kryetarin e Stambollit. Arrestimi i kryetarit shënon

një përshkallëzim të shtypjes së qeverisë ndaj figurave opozitare dhe zërave kritikë. Para arrestimit të tij, Imamoglu veçse përballej me disa raste penale që mund të rezultnin me dënim me burgim dhe me një ndalesë politike. Ai ishte në proces të

apelimit të një dënimi të shqiptuar më 2022 për fyerjen e anëtarëve të Këshillit Suprem Zgjedhor të Turqisë.

Më herët gjatë javës, një universitet anuloi diplomën e tij, duke thënë se kishte pasur parregullsi gjatë transferimit të Imamoglut nga një universitet privat në Qipro rreth 30 vjet më parë. Ky vendim në mënyrë efektive ia ndalon atij që të garojë për president, pasi ky post kërkon që kandidatët të kenë diploma universitare. Imamoglu është zotuar se do ta sfidojë vendimin.

Imamoglu ishte zgjedhur kryetar i qytetit më të madh në Turqi në mars të vitit 2019, duke i dhënë një goditje të rëndë Erdoganit dhe partisë së tij e cila kishte udhëhequr Stambollin për një çerek shekulli. Partia e Erdoganit kishte tentuar ta anulonte rezultatin e zgjedhjeve lokale, duke pretenduar se kishte pasur parregullsi.

Pas kësaj, zgjedhjet u përsëritën dhe Imamoglu fitoi sërish.

Papa Françesku lirohet nga spitali

VATIKAN, 23 MARS - Papa Françesku u largua nga spitali Gemelli në Romë më 23 mars, pasi për pesë javë u përball me pneumoni. Me të dalë nga spitali, Papa përshëndeti turmën e mbledhur dhe vetura me të cilën po udhëtonte u nis drejt një kishe në Romë dhe më pas në shtëpinë në Vatikan.

Në Vatikan turma të mëdha njerëzish u mblodhën nëpër rrugë për ta pritur Papën 88-vjeçar.

Të shtunën mjekët njoftuan se Papa do të lirohej nga

spitali, por ai, thanë mjekët, duhet të shmangë takime me grupe të mëdha njerëzish dhe të mos i shkaktojë vetes lodhje. Pas një kohe mjekët thanë se Ati i Shenjtë mund t'u rikthehet të gjitha aktiviteteve normale.

Papa argjentinës, i cili kur ishte i ri kishte hequr një pjesë të mushkërisë, ishte shtruar në spitalin Gemelli më 14 shkurt për shkak se gjendja e tij me bronkit u përkeqësua. Mjekët fillimisht e diagnostikuan me një infeksion të frymëmarrjes dhe

më pas thanë se ai kishte pneumoni në të dy mushkëritë. Analizat e gjakut shfaqën shenja të anemisë dhe probleme me veshka, por këto ndërlikime u përmirësuan pasi Papa iu nënshtrua dy trajtimeve me transfuzion të gjakut.

Më 28 shkurt gjendja e tij u përkeqësua, pasi pati probleme të frymëmarrjes dhe u desh të merrte oksigjen përmes një maske. Ai, po ashtu, përjetoi dy kriza të frymëmarrjes disa ditë më vonë.



STAGNIMI NË DIALOG SPROVON BE-në

Tetëmbëdhjetë muaj pa një takim të nivelit të lartë - dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë ka mbetur në vendnumëro. Me të dyja vendet të përfshira nga sfidat e brendshme, marrëveshja përfundimtare duket e largët. Analistët argumentojnë se bashkësia ndërkombëtare duhet ta shtyjë përpara njohjen reciproke mes tyre, jo thjesht normalizimin e marrëdhënieve, dhe të ketë një plan B nëse dialogu dështon

PRISHTINË, 23 MARS - Vizita e parë e Peter Sorensenit në Prishtinë, si i dërguar i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, erdhi në një moment kur ky proces nuk duket se është në agjendën e dikujt. Në Kosovë, vëmendja mbetet te çështjet paszgjedhore, ndërsa Serbia përballet me protesta dhe trazira të brendshme. Pavarësisht prej këtyre, mesazhi i emisarit evropian ishte i qartë: dialogu duhet të vazhdojë. “Dialogu është për t’u siguruar që të ketë takime. Se a do të thotë kompromis a jo, iu takon palëve për ta përcaktuar. Dialogu është për këtë dhe këtë jemi duke e bërë që nga viti 2011”, tha Sorenseni më 17 mars në Prishtinë.

Para 14 vjetësh kanë nisur raundet e para të bisedimeve mes Kosovës dhe Serbisë, të ndërmjetësuara nga Bashkimi Evropian. Ndër vite, ato janë zhvilluar herë më me vrull, herë më ngadalë. Ka pasur me dhjetëra marrëveshje e zotime, por shumë prej tyre nuk janë zbatuar.

Udhëheqësit, ndërkohë, kanë ndërruar në Bruksel, në Prishtinë e në Beograd por, njësoj, ka ndërruar edhe narrativën. Nëse dikur flitej për njohjen e ndërsjellë si qëllim kryesor, tani flitet vetëm për normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve.

Sorenseni, pasi takoi krerët shtetërorë të Kosovës, theksoi nevojën për ta vazhduar dialogun, por tha se do që t’i dëgjojë të dyja palët përpara se të vendosë për hapat e ardhshëm. “Qëllimi është të vazhdojë procesi dhe të ecet përpara. Unë kam diskutime këtu në Prishtinë, por më duhet të shkoj edhe në Beograd. Pasi t’i zhvilloj këto biseda, do të ulem dhe të shoh se ku jemi”, tha Sorenseni.

Dy palët nuk duket se janë askund afër. Bisedime të nivelit të lartë mes tyre nuk ka pasur qysh në shtator të vitit 2023.

Më 14 të atij muaji kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, janë takuar në Bruksel me ndërmjetësimin e udhëheqësve të atëhershëm evropianë, Josep Borrell dhe

Miroslav Lajčak.

Dhjetë ditë pas atij takimi ka ndodhur sulmi i armatosur në Banjskë, ku grupe të armatosura serbësh kanë vrarë një polic të Kosovës.

Përprjekjet e mëvonshme të BE-së për t’i ulur dy liderët bashkë në tryezë kanë dështuar - kryesisht për shkak të kushteve që i ka paraqitur njëra palë, e që tjetra i ka kundërshtuar.

Pas takimit me Sorensenin, edhe Kurti, edhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, kanë pasur një sërë kërkesash për të: nga heqja e masave ndëshkuese të BE-së kundër Kosovës deri te dorëzimi i grupit që ka sulmuar Banjskën tek autoritetet e Kosovës.

Për vëzhguesit e procesit të dialogut, topi, në fakt, është në fushën e BE-së. Ata thonë se është koha që ky bllok të fokusohet te një qëllim specifik, që është njohja e ndërsjellë mes dy vendeve pasi, sipas tyre, kjo është zemra e problemit dhe kjo duhet të adresohet direkt.

Leon Hartwell, bashkëpunëtor i lartë në LSE IDEAS - Shkolla e Londrës për Ekonomi, flet më shumë për programin “Expose” të Radios Evropa e Lirë: “Është vërtet e rëndësishme që njohja e ndërsjellë të vihet në ballë të këtij dialogu, sepse ideja e normalizimit është shumë e papërcaktuar. Nëse nuk keni një qëllim të qartë, ju as nuk përpiqeni të arrini diçka specifike”. “Ndaj, mendoj se Sorenseni duhet ta vendosë këtë qëllim përpara, që të mund t’i lëvizë palët në një drejtim të caktuar dhe ta zgjidhë këtë konflikt njëherë e përgjithmonë”, thotë Hartwelli. Vuçiqi këmbëngul se Serbia nuk do ta njohë kurrë pavarësinë e Kosovës. Fokus i tij është themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, gjë të cilën shpesh e nxjerr edhe si kusht për vazhdimin e dialogut me palën tjetër.

Për këtë asociacion ka një marrëveshje qysh në vitin 2013, porse Kosova - pavarësisht prej trysnisë ndërkombëtare - nuk e ka zbatuar kurrë, nga frika se një mekanizëm i tillë, me kompetenca të gjera, do të



mund të ndikonte në funksionalitetin e shtetit.

Kosova ka kohë që ka marrë një draft të hartuar nga BE-ja për statutin e këtij asociacioni, por edhe ai duket se është jashtë tryezës tashmë.

Presidentja Osmani tha këtë javë se drafti, si i tillë, nuk do të merrte dritë jeshile nga Gjykata Kushtetuese e vendit. “Unë, personalisht, besoj se nuk është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, nuk është në përputhje as me vlerat dhe normat e Bashkimit Evropian dhe standardet e Këshillit të Evropës, as me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të vitit 2015”, tha Osmani.

Një asociacion me kompetenca të gjera do të vinte me rrezikun e krijimit të një Republike Sërpska në Kosovë, thotë Hartwell, duke iu referuar entitetit serb në Bosnjë-Hercegovinë, i cili ka pushtet legjislativ. “Ekziston një perceptim i fortë se Asociacioni do të ndihmonte në përparimin e dialogut, por unë jam shumë skeptik për këtë. Një opsion ndoshta për Kosovën do të ishte që të prezantonte një version të zbutur të Asociacionit dhe, në njëfarë mënyre, ta zbatonte atë, vetëm për t’i heshtur kritikët”. “Por, theksoj se zbatimi i Asociacionit me kompetenca të forta ekzekutive do të bëhej mjaft problematik për Kosovën”, thotë Hartwelli.

Kurt Bassuener nga Këshilli për Politikën e Demokratizimit në Berlin thotë se Bosnjë-Hercegovina, për shkak të organizimit të brendshëm që ka, ka mbetur çështje e hapur prej dekadash. Nuk e përjashton mundësinë që edhe kontesti mes Kosovës dhe Serbisë të mbetet i tillë, ndaj sugjeron që të gjitha palët t’i kthehen qëllimit të deklaruar fillestar: njohjes së ndërsjellë. “Askush nuk flet më për njohje të ndërsjellë. Të gjithë

flasin për një normalizim dhe kjo nuk është në interesin e Kosovës, e do të thosha se nuk është as në interesin e një Serbie demokratike”, thotë Bassuener. Në vazhden e ndryshimeve të shpejta gjeopolitike, ai thotë se Ballkani Perëndimor në përgjithësi është një rajon ku BE-ja ka potencial të madh për të ndikuar në stabilizimin e situatës dhe çështja e Kosovës dhe Serbisë, sipas tij, është thelbësore për këtë stabilitet. “Shpresoj të ketë një rivlerësim dhe riorganizim të politikave nga Bashkimi Evropian. Nuk shoh ende asnjë provë për këtë - as në institucionet e BE-së dhe as në shtetet anëtare - edhe pse duhet kohë më e gjatë për ta kthyer anijen në drejtim tjetër”. “Është e kuptueshme që janë fokusuar në atë se si t’i ndihmojnë ukrainasit, nëse amerikanët tërhiqen, si ta mbrojnë veten në mënyrë legjitime... Këto janë prioritetet, por Ballkani Perëndimor është i vetmi vend në botë ku BE-ja mund të jetë vërtet vendimtare”, thotë Bassuener për “Exposenë”. Analistët besojnë se BE-ja ka ende leva ndaj Kosovës dhe Serbisë për t’i shtyrë përpara drejt një marrëveshjeje, edhe pse kushtëzimi i integritetit të tyre evropian me normalizimin e marrëdhënieve deri më tash nuk ka dhënë rezultate.

Hartwelli thotë se Perëndimi duhet të ketë një plan të qartë B nëse dialogu dështon. “Një nga zgjidhjet mund të jetë që pesë shtetet që nuk e kanë njohur ende Kosovën, ta njohin atë sepse, në atë rast, Serbia nuk mund të thotë se çështja e njohjes së Kosovës është ende në ajër. Asaj do t’i duhej të merrej me një Kosovë që njihet nga të gjitha vendet anëtare të BE-së. Dhe nëse vërtet dëshiron të anëtarësohet në BE, Serbia do të duhet të punojë brenda kësaj kornize”, thotë Hartwell.

Megjithatë, disa kanë hamendësuar se me presidentin Donald Trump në Shtëpinë e Bardhë, Serbia ka më shumë hapësirë veprimi për shkak të lidhjeve të saj më të ngushta - qofshin politike, qofshin ekonomike - me njerëz të afërt me Trumpin.

Ndaj analistët thonë se fokusi i Kosovës duhet të jetë te ruajtja e mbështetjes dypartiake në Uashington. Sipas Hartwellit, vendi duhet të pozicionet si një partner i besueshëm, sidomos në çështjet e sigurisë dhe ekonomisë, si dhe ta rrisë bashkëpunimin me ShBA-në në fushën e energjisë dhe mbrojtjes.

Vitet e fundit Qeveria e Kosovës, e udhëhequr nga Albin Kurti, është përballur me kritika të herëpashershme nga zyrtarët amerikanë për shkak të disa veprimeve në veri të vendit, të cilat i kanë cilësuar të pakoordinuara dhe me ndikim të keq te komuniteti serb.

Kontakti i fundit i ditur, që Kosova ka pasur me Shtëpinë e Bardhë, ka qenë një letër që presidenti Trump i ka dërguar presidentes Osmani me rastin e 17-vjetorit të pavarësisë së Kosovës në muajin shkurt.

Në atë letër Trumpi është zotuar për zgjerimin e lidhjeve me Kosovën dhe nuk e ka përmendur fare dialogun për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit.

Në BE nuk i janë përgjigjur pyetjes së Radios Evropa e Lirë nëse planifikojnë të thërrasin ndonjë takim mes udhëheqësve të të dyja vendeve së shpejti. Po ashtu, nuk është e qartë nëse ata do t’i përgjigjeshin ftesës.

Me Kosovën ende pa qeveri të re, pas zgjedhjeve të shkurtit, dhe me protestat e vazhdueshme në Serbi, e vetmja gjë që lëviz me siguri përpara është kalendari.



OPOZITA KUNDËRSHTON SHTRENJTIMIN E ÇMIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Nga 1 prilli i këtij viti çmimi i energjisë elektrike në Kosovë do të rritet 15 % më shumë. Kryetari i Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRrE) ka thënë se nëse më herët kemi paguar 50 euro, tani do të paguajmë 58 euro. Partitë opozitare kanë thënë se zbatimi i vendimit të ZRrE-së do të ketë pasoja të rënda për ekonominë e vendit dhe mirëqenien e qytetarëve. Sipas tyre, rritja e çmimit të energjisë është goditja e parë, por jo e fundit, sepse kur bizneseve u rriten shpenzimet, atëherë çmimet e të gjitha produkteve bazë do të rriten përsëri

përpjekje për ta ndaluar. “Përkundrazi, duke u fshehur pas terminologjisë së ‘liberalizimit të tregut’, ajo po e shtyn një skenar të rrezikshëm që rëndon mbi familjet dhe ekonominë e vendit”, tha Shala. Deputeti Ferat Shala, duke përmendur pasojat e vendimeve të qeverisë aktuale në pesë vitet e fundit në sektorin e energjisë, tha se familjet e Kosovës po përballen me rritje të faturave të energjisë, duke ndikuar drejtpërdrejt në përkeqësimin e mirëqenies së tyre. “Bizneset po detyrohen të hyjnë në një treg të paqëndrueshëm, pa alternativa reale dhe me rrezikun e rritjes së kostove operacionale. Asnjë garanci nuk është dhënë se ky proces do të sjellë shërbime më cilësore për konsumatorët. Kjo rritje do të reflektojë edhe në një inflacion të lartë, veçanërisht për prodhimin vendor. Për Kosovën, ku tregu energjetik ka qenë shpesh subjekt i manipulimeve dhe skandaleve, ky hap është i rrezikshëm dhe i papërgjegjshëm”, tha Shala. Ai tha se PDK-ja nuk është kundër reformave dhe zhvillimit të tregut të energjisë,

por ato duhet të ndodhin në kushte të drejta dhe transparente, ku interesi i qytetarëve dhe bizneseve vendore të jetë prioritet. “Kjo do të thotë garantim i konkurrencës së vërtetë në treg, me më shumë furnizues dhe oferta të qarta për konsumatorët. Shtimin e kapaciteteve të reja prodhuese për të siguruar stabilitet dhe pavarësi energjetike. Krijimin e një mekanizmi mbrojtës për konsumatorët e ndjeshëm, për t’i shmangur goditjet e papritura në ekonomi familjare dhe biznese”, tha Shala. Qeveria aktuale, sipas Shalës, duhet ta ndalojë menjëherë këtë politikë të dëmshme dhe të ndërmarrë hapa konkretë për mbrojtjen e konsumatorëve. “Ne nuk do të lejojmë që familjet dhe bizneset e Kosovës të jenë viktimat e radhës të eksperimenteve të gabuara ekonomike. Partia Demokratike e Kosovës do t’i përdorë të gjitha mjetet institucionale dhe ligjore për ta kundërshtuar këtë vendim të padrejtë, përfshirë kontestimin e tij në Gjykatën Kushtetuese”, tha Shala. Edhe deputetja e PDK-së,

Hykmete Bajrami, ka thënë se zbatimi i vendimit të ZRrE-së do të ketë pasoja të rënda për ekonominë e vendit dhe mirëqenien e qytetarëve. “Nga 1 prilli i këtij viti çmimi i energjisë rritet 15 %. Kryetari i Bordit të ZRrE-së thotë: ‘Nëse keni paguar 50 euro, tani do të paguani 58 euro’ (në të vërtetë, rritja prej 15 % e çon faturën në 57.5€ jo në 58)”, ka thënë Bajrami. Ajo ka thënë se janë disa fakte që duhet të thuhën zëshëm. “Shumica e familjeve nuk paguajnë 50 euro në muaj, por më shumë. Rritja prej 15 % e çmimit të energjisë për shpenzuesit komercialë (bizneset) është drejtpërdrejt kosto shtesë për të gjitha produktet dhe shërbimet e tyre. Rritja e çmimit të energjisë është goditja e parë, por jo e fundit, sepse kur bizneseve u rriten shpenzimet, atëherë çmimet e të gjitha produkteve bazë do të rriten përsëri si: çmimi i bukës, qumështit, vajit, sheqerit, transportit dhe çdo produkti tjetër të domosdoshëm për jetesë. Pra, standardi i jetesës në vitin 2025 do të jetë më i ulët se ai i vitit 2020. Shto këtu faktin se ZRrE-ja po i hedh në treg të hapur 1

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 23 MARS - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Ferat Shala, ka thënë në një konferencë për medie të dielën se paralajmërimi për shtrenjtimin e serishëm të çmimit të energjisë elektrike do t’i dëmtojë rëndë qytetarët dhe bizneset e Kosovës. Shala tha se qeveria aktuale, në emër të liberalizimit të tregut, po favorizon një grup të vogël të tregtarëve të energjisë, duke vënë barrën më të rëndë mbi familjet dhe bizneset e Kosovës.

“Vendimi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRrE) për t’i detyruar bizneset të paraqiten në KEDS për tregun e hapur do të krijojë pasiguri dhe vështirësi të mëdha për ta. Për më tepër, mungesa e konkurrencës reale në tregun e energjisë do të thotë vetëm një gjë: çmime më të larta dhe kushte më të pafavorshme për konsumatorët”, tha Shala. Në pesë vitet e fundit qytetarët e Kosovës janë përballur disa herë me shtrenjtimin e çmimit të energjisë elektrike, të cilin kjo qeveri nuk ka bërë asnjë

000 kompanitë më të mëdha të vendit. Sipas vendimit të ZRrE-së, nga 1 qershori i këtij viti KESCO nuk e ka obligim t’i furnizojë më me energji elektrike këto kompani, ato duhet ta blejnë energjinë në tregun e hapur. Praktikisht kjo do të thotë se këto 1 000 kompani nuk mund ta blejnë energjinë që prodhon KEK-u, por duhet të blejnë energji të importuar me çmim së paku dyfish më të shtrenjtë (shih çmimet në bursë), me ç’rast një pjesë e tyre edhe mund të falimentojnë, disa do të përfundojnë me largim nga puna të punëtorëve për t’i ulur shpenzimet, e të gjitha do të detyrohen t’i rrisin çmimet për të mbijetuar, gjë që do t’i bëjë ato jokonkurrese në tregun vendor dhe atë ndërkombëtar, rrjedhimisht kjo çon deri te lulëzimi i importit edhe ashtu tepër i lartë”, ka thënë Bajrami.

Ajo ka treguar se kush përfiton nga ky vendim? “KESCO dhe tregtarët e energjisë, apo siç i quante Kurti kur ishte në opozitë: ‘mafia energjetike’. Është e qartë se zbatimi i këtij vendimi çon drejt rrënimit të ekonomisë dhe mirëqenies së qytetarëve”, ka deklaruar

deputetja e LDK-së.

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, duke reaguuar rreth kësaj teme, ka thënë se Albin Kurti e shkatërroi sektorin e energjisë me vendimet e papërgjegjshme. “Me krenari e pati anuluar kontratën për ndërtimin e termocentralit të ri, duke i humbur Kosovës 21 milionë euro dëm në arbitrazh. Endaloi gazsjellësin amerikan dhe çdo investim strategjik, duke e lënë vendin pa asnjë alternativë të sigurt dhe afatgjatë për energjinë. Përfitues të kësaj politike të qëllimshme janë vetëm tregtarët e energjisë dhe klika e tij politike, ndërsa humbësi i vetëm është qytetari i Kosovës! Sot, përballë krizës ekonomike dhe rritjes së çmimeve të çdo produkti jetik, qeveria e godet edhe një herë qytetarin me rritjen e çmimit të rrymës. Paralajmërimi i ZRrE-së për shtrenjtim prej 15 % nga 1 prilli është një goditje e rëndë për mirëqenien e familjeve kosovare dhe për ekonominë e vendit. Kjo qeveri është e paaftë dhe e rrezikshme. Prandaj Kosova ka nevojë për një udhëheqje që i mbron qytetarët, e jo që i dëmton ata”, ka theksuar Haradinaj.

OEK i drejtohet Avokatit të Popullit për liberalizimin e tregut të energjisë

Oda Ekonomike e Kosovës i është drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, duke i kërkuar të iniciojë lëndë në Gjykatën Kushtetuese për të pezulluar për një vit vendimin për kalimin e bizneseve në tregun e hapur të energjisë.

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka kërkuar që të gjitha kompanitë me mbi 50 punëtorë ose me qarkullim mbi 10 milionë euro, të dalin në tregun e hapur të energjisë nga 1 qershori.

Oda Ekonomike i kërkoi Avokatit të Popullit ta dërgojë këtë lëndë në Kushtetuese, pasi argumentoi se një kalim i tillë në treg të hapur do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në koston e prodhimit apo shërbimit. “Një rritje e tillë do të ndikonte negativisht në konkurrueshmërinë e bizneseve në tregun e brendshëm dhe atë të jashtëm, duke ulur gjithashtu standardin jetësor të qytetarëve”, ka njoftuar OEK.

Në kërkesën drejtuar Avokatit të Popullit, OEK renditi arsyet e

kërkesës për një pezullim njëvjeçar. Kjo odë tha se bizneset argumentojnë se dalja nga tregu i rregulluar mund të sjellë rritje të ndjeshme të kostove të energjisë, duke ndikuar drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë financiare. “Shumë kompani nuk janë të përgatitura për këtë kalim dhe kanë nevojë për më shumë kohë për t’u përshtatur me modelin e tregut të lirë”, tha OEK-u, duke shtuar se një kalim i menjëhershëm në një treg të liberalizuar të energjisë do të bënte që bizneset më të vogla të penalizoheshin më shumë, duke “ndikuar negativisht në konkurrencë”.

Po ashtu, OEK-u kërkon që me këtë vendim të mos caktohet një numër i përcaktuar i punonjësve apo një prag mbi vlerën e qarkullimit si kriterë për daljen në tregun e hapur. “Duke marrë parasysh këto shqetësime, bizneset i bëjnë thirrje ZRRE-së ta shqyrtojë mundësinë e shtyrjes së afatit për kalimin në tregun e hapur të energjisë për të paktën një vit. Një periudhë tranzicioni më e gjatë do t’u lejonte kompanive t’i përshtatin strategjitë e tyre dhe t’i shmangin goditjet e papritura financiare”, ka njoftuar OEK-u

në kërkesën drejtuar Avokatit të Popullit.

Si pjesë e Ligjit për Energjinë Elektrike, vendimi i ZRRE-së nënkupton që bizneset duhet ta zgjedhin vetë furnizuesin e tyre me energji elektrike. Sipas ZRRE-së, konsumatorët që dalin në tregun e liberalizuar të energjisë mund të furnizohen nga çdo kompani vendore që ka licencë ose nga kompani të huaja.

Operatori për Furnizim me Energji (KESCO) është furnizuesi kryesor i licencuar për energji elektrike në Kosovë. Çmimet e produkteve të KESCO-s i përcakton ZRRE-ja. Por, ZRRE-ja ka thënë se në vend janë të licencuar edhe 18 kompani të tjera që ofrojnë këtë shërbim.

Më 5 mars, përmes një njoftimi, KESCO tha se, bazuar në kërkesën e ZRRE-së, kompanitë që kanë mbi 50 punëtorë apo qarkullim mbi 10 milionë euro do të duhet ta zgjedhin furnizuesin me rrymë brenda 15 ditësh pasi, nga data 1 qershor, nuk do të jenë më në listën e konsumatorëve me tarifa të rregulluara. Ato do të kalojnë në furnizim me çmime të parregulluara, të cilat përcaktohen nga kërkesa dhe oferta në treg.



ÇFARË PËRMBAN DEKLARATA PËR BASHKËPUNIM USHTARAK NË MES TË KOSOVËS, SHQIPËRISË DHE KROACISË?

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 23 MARS - Eksplorimi i zhvillimit dhe blerjes së kapaciteteve mbrojtëse përmes bashkëpunimit shumëkombësh, ndarja e ekspertizave më të mira në rekrutim, zhvillim dhe mbajtjen e personelit për t'i rritur kapacitetet parandaluese dhe mbrojtëse, stërvitje të përbashkëta, forcimi i hapave kundër kërcënimeve hibride, shkëmbimi i informacioneve të inteligjencës për parandalim dhe mbështetja e Kosovës për marrjen e statusit të saj në Partneritetin për Paqe të NATO-s. Këto janë disa nga pikat që përfshin deklarata e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë që ministrat e Mbrojtjes të Kosovës, Shqipërisë dhe Kroacisë nënshkruan më 18 mars në Tiranë. Marrëveshja e plotë u publikua nga Ministria e Mbrojtjes e Kosovës.

Marrëveshja:

Duke njohur marrëdhëniet e forta dhe të qëndrueshme ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kroacisë dhe Republikës së Kosovës, të bazuara në vlerat e përbashkëta, orientimet strategjike dhe angazhimet reciproke drejt sigurisë dhe bashkëpunimit rajonal; Duke riafirmuar synimin tonë për të forcuar bashkëpunimin trepalësh të sigurisë dhe mbrojtjes për të rritur sigurinë dhe stabilitetin në Evropën Juglindore dhe në rajonin Adriatiko-Jonian; Duke theksuar rëndësinë e përpjekjeve të përbashkëta për t'iu përgjigjur sfidave të reja të sigurisë, kërcënimeve hibride dhe rrezeve të tjera që mund të dëmtojnë stabilitetin rajonal, evropian dhe ndërkombëtar; Marrja e veprimeve të

menjëhershme për zhvillimin e kapaciteteve mbrojtëse duke pranuar ambiciet që rrjedhin nga Koncepti Strategjik i NATO-s dhe Busulla Strategjike e Bashkimit Evropian, të konceptuara për të rritur aftësinë tonë për të mbrojtur territoret dhe njerëzit tanë, si dhe për të kontribuar për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare; Avancimi i hapave të përbashkët për të rritur bashkëpunimin dhe prodhimin industrial të mbrojtjes në përputhje me Zotimin e NATO-s për Zgjerimin Industrial dhe planin e Bashkimit Evropian për “Riarmatosjen e Evropës”;

Ne jemi të vendosur për t'u siguruar që jemi të pozicionuar mirë për t'u bërë ballë kërcënimeve aktuale dhe në zhvillim, si dhe për të arritur objektivat tona të mbrojtjes dhe sigurisë;

Ne: Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, Zëvendëskryeministri dhe Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Kroacisë, si dhe Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës, deklarojmë angazhimin tonë si më poshtë:

1. Promovimi i kapaciteteve mbrojtëse dhe bashkëpunimi për industrinë përkatëse duke:

- Eksploruar zhvillimin dhe blerjen e kapaciteteve mbrojtëse nëpërmjet zgjidhjeve të bashkëpunimit shumëkombësh për të rritur gatishmërinë e forcave tona ushtarake;
- Identifikuar hapësira për bashkëpunimin industrial të mbrojtjes, duke nxitur aksesin në burime dhe zinxhirë furnizimi për të krijuar një industri konkurruese dhe të qëndrueshme të mbrojtjes;
- Rritur përpjekjet për të investuar në teknologji dhe inovacione të reja për të përshpejtuar dhe siguruar një qasje të unifikuar ndaj transformimit të sigurisë dhe mbrojtjes.

2. Rritja e ndërveprueshmërisë



nëpërmjet edukimit, trajnimeve dhe stërvitjeve duke:

- Ndarë ekspertizën dhe praktikat më të mira në rekrutimin, zhvillimin dhe mbajtjen e personelit të kualifikuar, duke përfshirë shkëmbimin e koncepteve të forcave rezerviste, për të rritur kapacitetet tona parandaluese dhe mbrojtëse;
 - Rritur mundësitë e edukimit dhe trajnimit individual dhe kolektiv përmes akademive dhe kolegeve ushtarake përkatëse, me qëllim që të ketë kuptueshmëri më të mirë nga ana strategjike të kërcënimeve dhe sfidave të përbashkëta;
 - Forcuar stërvitjet dypalëshe dhe/ose trepalëshe për të përmirësuar ndërveprueshmërinë, në përputhje me Politikën e NATO-s dhe BE-së për Trajnimet dhe Stërvitjet, për t'u siguruar që forcat të jenë të përgatitura në mënyrë adekuate.
3. Kundërpërgjigja ndaj kërcënimeve hibride dhe rritja e qëndrueshmërisë duke:

- Forcuar hapat e përbashkët për t'iu kundërpërgjigjur kërcënimeve hibride, duke përfshirë kërcënimet kibernetike, fushatat e dezinformimit, si dhe ndikimin dashakeq të huaj që mund të komprometojë ose të ndikojë në sigurinë kombëtare dhe rajonale;
 - Shkëmbyer informacione dhe shërbime të inteligjencës për ndërgjegjësimin dhe koordinimin strategjik dhe operacional të situatës ndërmjet institucioneve të mbrojtjes për të parandaluar, zbuluar dhe reaguar në mënyrë efektive kundër sfidave që hasin vendet tona përkatëse;
 - Eksploruar opsione të reagimit që adresojnë një gamë të gjerë kërcënimesh të mundshme për infrastrukturën tonë kritike dhe rrjetet e komunikimit dhe që mbështesin kohezionin dhe ndihmën e ndërsjellë.
4. Ofrimi i mbështetjes së plotë për integrimin euroatlantik duke:
- Përafruar politikën dhe pozicionet me institucionet dhe

strukturat shumëpalëshe euroatlantike për sigurinë dhe mbrojtjen, për të çuar përpara interesat dhe objektivat tona kombëtare dhe të përbashkëta rajonale;

- Treguar angazhim për bashkëpunim dhe koordinim më të ngushtë për integrimin e plotë të Kosovës në iniciativat rajonale për sigurinë mbrojtjen;
- Mbështetur perspektivën euroatlantike të Kosovës duke ofruar mbështetje për statusin e saj në Partneritetin për Paqe të NATO-s.

Kjo Deklaratë e Përbashkët është bërë në frymën e miqësisë, solidaritetit dhe besimit të ndërsjellë. Ajo pasqyron vizionet e përbashkëta strategjike të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kroacisë dhe Republikës së Kosovës. Ajo nuk krijon asnjë detyrim të ri ligjor ndërkombëtar ose ndërqeveritar ndërmjet shteteve, as nuk ndikon në detyrimet ekzistuese me shtetet e tjera.

IKSHPK-ja: VAKSINA MBETET MËNYRA MË E SIGURT PËR PARANDALIMIN E FRUTHIT

PRISHTINË, 23 MARS - Pas regjistrimit të disa rasteve me fruth në Kosovë, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) thotë se vakcina mbetet mënyra më e sigurt për parandalimin e kësaj sëmundje. Profesionistët shëndetësorë u kanë bërë thirrje prindërve t'i vaksinonjë fëmijët kundër fruthit, shytave dhe rubeolës (vakcina MMR). Ndonëse nga viti 2018 nuk kishte raste të fruthit, që nga ky fillim vit në Kosovë ka pasur raste me fruth, andaj me qëllim të mbrojtjes nga kjo sëmundje ngjitëse e që kryesisht i prek fëmijët, IKShPK ka bërë thirrje për vaksinim. Kështu i tha Radio

Kosovës Faik Hoti nga ky institucion. Ai tha se deri më tani me fruth ka pasur dy raste në muajin janar dhe tri raste në muajin mars. Megjithatë, Hoti u ka bërë thirrje prindërve t'i vaksinonjë fëmijët me doza të vaksinave sipas kalendarit të vaksinimit, me vaksinën MMR e cila është kundër fruthit. “Që nga janari e deri më tani kanë qenë gjithsej pesë raste dhe se jemi duke e monitoruar në mënyrë të vazhdueshme, dhe shpresojmë që të mos ketë me raste të tjera. Thirrja për vaksinim u dedikohet prindërve që t'i vaksinonjë fëmijët. Pasi që fruthi dallon shumë prej gripit, pasi që e ka përhapjen më të shpejtë dhe ka potencial që të shkaktojë



komplikime të fëmijët”, tha Hoti. Ndërsa nga Qendra e Mjekësisë Familjare nr. V në Dardani thonë

se nuk kanë pasur asnjë rast me fruth. Megjithatë, doktoresha Hamide Morina nga kjo QMF, u

bën thirrje prindërve t'i vaksinonjë fëmijët e tyre me vaksinën kundër fruthit. “Në Qendrën e Mjekësisë Familjare nr. V në Dardani deri më tani nuk kemi pasur asnjë rast që ka kërkuar ndihmë mjekësore si pasojë e fruthit. Megjithatë apeloj te të gjithë prindërit që mos të hezitojnë t'i sjellin fëmijët për vaksinim kundër fruthit”, tha Morina. IKShPK ka njoftuar se fëmijët të cilët për arsye të ndryshme nuk kanë arritur ta marrin vaksinën sipas kalendarit të rregullt, mund të vaksinohen në çdo kohë, duke qenë se ajo mund të jepet edhe pas moshës 6 vjeçe, por me rëndësi të merren të dy dozat e vaksinës.

Shpenzimet e buxhetit 2024, ku shkuan mbi 3 miliardë euro?

PRISHTINË, 23 MARS - Qeveria e Kosovës nuk arriti t'i shpenzojë gati 120 milionë euro nga buxheti i vitit 2024. Përderisa shpenzimet për kategori të ndryshme kanë pësuar rritje, për investime kapitale kanë mbetur të pashpenzuara rreth 200 milionë euro të planifikuara, ndërkohë që për të tjerat, si për transfere sociale, mallra, subvencione dhe paga, shpenzimet kanë qenë më të mëdha krahasuar me vitin e kaluar. Por analistët kritikojnë mënyrën e shpenzimit të buxhetit 2024.

Sipas Institutit GAP, referuar raportit zyrtar të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, mbi 3.195 miliardë euro u shpenzuan gjithsej pagesa në vitin e kaluar nga mbi 3.314 miliardë sa ishte miratuar buxheti.

Ky raport thotë se në janar të vitit 2024 janë shpenzuar mbi 140 milionë euro, pasuar nga muajt e tjerë me mbi 210 milionë euro, përveç dhjetorit ku u shpenzuan mbi 580 milionë euro. Sipas GAP-it, mbi 650 milionë euro kanë shkuar për shpenzime kapitale, ndërsa për subvencione mbi 1 miliard e 114 milionë euro. Ata thonë se krahasuar me vitin 2022 dhe 2023, ka një dinamikë të përsheptuar të shpenzimit të buxhetit.

Drejtori ekzekutiv në Institutin GAP, Blendi Hasaj, ka thënë për "KosovaPress" se krahasuar me dy vitet e kaluara, në 2024-n ka pasur shpenzim më të lartë për investime kapitale. Sa i përket buxhetit total në realizim, në vitin 2023 Qeveria e Kosovës nuk arriti t'i shpenzojë mbi 286 milionë euro, në vitin 2022 mosshpenzimi i buxhetit ishte mbi 123 milionë euro. "Në vitin 2024 nga të dhënat buxhetore dallojmë që kemi një dinamikë më të përsheptuar të shpenzimit të



buxhetit, në të gjitha kategoritë. Për herë të parë që nga pas lufta i kemi mbi 3 miliardë euro buxhet të realizuar. Krahasuar me vitet e mëhershme 2023 apo 2022, edhe në kategoritë kyçe kemi një shpenzim më të lartë dhe këtu e kam fjalën për shpenzimet kapitale. Dallohet që në vitin 2024 realizmi i investimeve kapitale ishte në një nivel thënë ndjeshëm më të lartë se në vitet e fundit, 2023 apo 2022. Realisht, është shkalla më e lartë e realizmit të investimeve kapitale që nga viti 2018. Një gjetje tjetër është që edhe te pjesa e subvencioneve dhe transfereve sociale, rritja nuk ka qenë e ndjeshme. Është mirë që mos të na shtohet shumë barra buxhetore nga ana veçmas e transfereve sociale si vend", thotë Hasaj. Ndërkaq lidhur me atë se shpenzimi i buxhetit të vitit 2024 kishte marrë hov më shumë muajt e fundit, sipas Hasajt, kjo mund të ndodhë për shkak se bizneset i realizojnë punët më shumë në pjesën e dytë të vitit.

Për këtë dinamikë të shpenzimit të buxhetit, ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu,

thotë se duhet të rritet llogaridhënia dhe të ketë përgjegjësi. Ai shprehet se buxheti i Kosovës është i politizuar e që, sipas tij, në këtë rast Kosova dëmtohet në vend se të zhvillohet. "Viti 2024 lë hapësirë për t'u dëshiruar. Ka qenë një buxhet i një vlere prej 3 miliardë e 360 milionë eurosh, i cili vërtet nuk mund t'i përmbushë të gjitha objektivat dhe qëllimet e zhvillimit të qëndrueshme të ekonomisë së Kosovës. Mirëpo ajo çka vërehet është fakti që ekonomia e Kosovës është politizuar. Derisa ka politizim të tillë edhe në buxhet, besoj se Kosova shumë më tepër dëmtohet sesa që mbështetet për t'u zhvilluar. Është një karakteristikë e kësaj qeverie fakti që deri në muajin tetor 2024 kemi pasur një përqindje shumë të vogël të shpenzimit të buxhetit, qoftë në komuna, qoftë në nivelin qendror. Është mjaft shqetësuese. Në këtë aspekt, besoj se duhet të rritet llogaridhënia, duhet të ketë përgjegjësi, mbi të gjitha duhet dialog dhe komunikim të mirëfilltë", thotë Gërxhaliu. Eksperti i ekonomisë thotë se orientimi i investimeve është më shumë i ngjyrosur

politikisht siç potencon ai sesa që ka projekte konkrete. Sipas tij, mungesa e investimeve të mjaftueshme në projekte kapitale po e ngulfat zhvillimin ekonomik dhe po e pengon fuqizimin e sektorit privat.

Në vitin 2023 për investime kapitale u shpenzuan rreth 561 milionë euro, derisa në vitin 2022 kjo shifër ishte mbi 422 milionë euro. "Nëse e bëni një strukturë nga niveli qendror në atë lokal e shihni që orientimi i investimeve është shumë më tepër i ngjyrosur politikisht sesa që ka projekte konkrete. E tëra kjo është duke e dëmtuar Kosovën në fusha të ndryshme. Nga keqmenaxhimi i buxhetit të vitit 2024, përveç qytetarëve, besoj koston më të lartë e pagan sektorit privat apo komuniteti i biznesit, i cili është kontribuuesi më i madh në grumbullimin e buxhetit. Mungesa e investimeve në projekte kapitale po e ngulfat zhvillimin ekonomik dhe fuqizimin e sektorit privat, po e fuqizon sektorin bankar dhe në këtë drejtim sot më shumë fitojnë bankat komerciale sesa sektori privat. Kjo duhet të jetë një vërejtje që cilado

qeveri që të jetë në të ardhmen, të mos përsërisë gabime si në të kaluarën", ka potencuar Gërxhaliu.

Nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve nuk janë përgjigjur lidhur me shpenzimin e buxhetit 2024 dhe për mënyrën e mbështetjes së sektorit privat. Sipas raportit të GAP-it, në kuadër të buxhetit 2024, Qeveria e Kosovës ka rritur shpenzimet për gati në të gjitha kategoritë gjatë vitit të kaluar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023.

Vetëm për transfere sociale janë shpenzuar mbi 780 milionë euro ose mbi 100 milionë më shumë gjatë vitit të kaluar krahasuar me vitin paraprak.

Krahas shpenzimeve, për mallra dhe shërbime, janë shpenzuar 432 milionë e 541 mijë euro më 2024 ose 34.5 milionë euro më shumë se në vitin 2023.

Po kështu për subvencione dhe transfere nga kjo qeveri janë shpenzuar gjatë vitit që lamë pas 1 miliard e 114 milionë euro ose 35 milionë euro më shumë se në vitin 2023. Përveç kësaj, për paga kjo qeveri ka shpenzuar 843 milionë e 675 mijë euro ose mbi 76 milionë më shumë se në vitin 2023.

Veç kësaj, për shpenzime kapitale janë shpenzuar mbi 650 milionë euro, derisa të planifikuara për këtë sektor kanë qenë 860 milionë euro. Në vitin 2023 ishin shpenzuar për investime kapitale mbi 560 milionë euro.

Ndryshe, për vitin 2025, Kuvendi i Kosovës miratoi buxhetin 3.6 miliardë euro, për vitin 2024 ishte 3.314 miliardë. Derisa në vitin 2023 vlera e buxhetit ishte mbi 3 miliardë e 212 milionë euro. Ndërkaq, në vitin 2022 buxheti i miratuar ishte 2 miliardë e 748 milionë euro.

Shtrenjtimi i energjisë, paralajmërohet rritje e çmimit të qumështit

PRISHTINË, 23 MARS - Shoqata e Industrisë së Qumështit të Kosovës ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës të ndërhyjë për ta ndaluar rritjen e çmimit të energjisë elektrike, duke theksuar se kjo rritje do ta dëmtojë rëndë sektorin e prodhimit të qumështit.

Në një reagim për medie, përfaqësues të Shoqatës kanë shprehur shqetësimin për ndikimin negativ që do të ketë shtrenjtimi i energjisë në koston e prodhimit të qumështit. Ata kanë theksuar se, përveç rritjes së kostove për ambalazhimin e produkteve dhe pagave të punëtorëve, industria e

qumështit tashmë po përballet me shpenzime të larta operative. "Me gjithë sakrificat e bëra deri tani për të ruajtur një paqe sociale për konsumatorët në Kosovë, nëse çmimi i energjisë rritet, do të detyrohemi të veprojmë. Shpresojmë në mirëkuptimin e klientëve tanë," thuhet në reagimin e Shoqatës.

Përfaqësuesit e Shoqatës theksojnë se, pavarësisht prej përpjekjeve për ta ruajtur stabilitetin e çmimeve, një rritje e mëtejshme e tarifave të energjisë do t'i detyrojë t'i rrisin çmimet e produkteve të qumështit.

Sektori i qumështit, që është ndër më të goditurit nga shtrenjtimi i

kostove të prodhimit, kërkon nga institucionet ta parandalojnë ndikimin e mëtejshëm të rritjes së tarifave të energjisë në zinxhirin e furnizimit me produkte ushqimore bazike. "Industria e qumështit në Kosovë ka qenë ndër sektorët më të goditur nga rritja e kostove të prodhimit dhe kërkon nga institucionet ta parandalojnë ndikimin e mëtejshëm të shtrenjtimit të energjisë në zinxhirin e furnizimit me produkte bazike ushqimore", thuhet në reagim.

Ky apel vjen pas njoftimit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për një rritje të mundshme prej 15 % të çmimit të energjisë elektrike.



MËSIMI QË PO MERR DONALD TRUMPI, ME NJË KOSTO TË LARTË



Robert KAGAN

Themeluesit e Shteteve të Bashkuara e dinin se amerikanët, për mirë apo për keq, kishin një dëshirë të pangopur për tregtinë ndërkombëtare.

“Janë po aq të lidhur me ujin sa breshkat dhe shpendët detarë,” vëzhgonte John Adams, “dhe dashuria për tregtinë, me gjithë komoditetet dhe kënaqësitë që sjell, është një zakon në natyrën e tyre, aq i pandryshueshëm sa vetë natyra.”

Që në vitin 1785 ai parashikonte se amerikanët do të detyroheshin të krijonin “lidhje me Europën, Azinë dhe Afrikën”, dhe këshillonte se “sa më shpejt t’i organizojmë këto lidhje në një sistem të mençur, aq më mirë do të jetë për ne dhe për fëmijët tanë.”

Thomas Jefferson do të kishte preferuar të ndalonte çdo tregti me pjesën tjetër të botës dhe të mbështetej tek virtytet e thjeshta të “fermerit të lirë”, por ai e dinte se kjo ishte e pamundur. “Populli ynë ka një prije për lundrim dhe tregti... dhe shërbëtorët e tyre kanë detyrimin të përlogarisin çdo veprim mbi këtë fakt.” Edhe ai që shpesh është karikaturuar si “xheksonian”, vetë Andrew Jackson, nuk qëlloi asnjëherë me armë si president, por negocioi më shumë marrëveshje tregtare me fuqitë e huaja sesa të gjithë paraardhësit e tij. Dashuria amerikane për tregtinë e bënte të vështirë përdorimin e saj si armë kundër kombeve të tjera.

Kur Jefferson harroi mësimin e vet dhe u përpoq të vendoste embargo ndaj tregtisë me Britaninë e Madhe në vitin 1807, si përgjigje ndaj abuzimeve të flotës britanike kundër tregtarëve amerikanë në det të hapur, përpjekja e tij pati efekt të kundërt, duke nxitur madje edhe biseda për shkëputje nga Unioni në shtetet e New England-it, që ishin më të varurat nga kjo tregti. Rezultoi më e lehtë të bindje amerikanët për të mbështetur një luftë të vërtetë me armë ndaj Britanisë, sesa një luftë tregtare.

Donald Trumpi tani po e mëson “në mënyrë të dhimbshme” se sa e ndjeshme është Amerika kur bëhet fjalë për luftërat tregtare.

Jo sepse Shtetet e Bashkuara nuk kanë, të paktën teorikisht, avantazh. Tregu amerikan është më i dëshiruari në botë dhe çdo kufizim në aksesin ndaj këtij tregu duhet të dëmtojë më shumë vendet e tjera sesa vetë Shtetet e Bashkuara. Raporti i tregtisë ndërkombëtare me PBB-në në SHBA është rreth 25 për qind, krahasuar me më shumë se 60 për qind mesatarisht për të gjitha vendet e tjera. Në Gjermani, tregtia e jashtme përbën 90 për qind të PBB-së. Kjo, teorikisht, duhet ta bëjë atë të ndjeshme dhe t’i japë SHBA-së përparësi.

Por në praktikë, amerikanët kanë treguar vazhdimisht se kanë një prag shumë të ulët tolerance për dhimbjet e një lufte tregtare.

Jefferson nuk gabonte kur besonte se Britania varej shumë nga tregtia me SHBA, kur nisi

embargon në vitin 1807; ajo që ai nuk parashikoi ishte se vetë qytetarët e tij do të dorëzoheshin para Britanisë. Problemi është, ose të paktën ka qenë deri më tani, demokracia! Më konkretisht, politika zgjedhore në një sistem federal ku interesat e ngushta lokale mund të kenë ndikim të gjerë në politikën kombëtare. Një mosmarrëveshje tregtare mund të dëmtojë vetëm një sektor të ekonomisë, por nëse ai sektor përkon me një bllok të rëndësishëm votuesish, kjo mund të vendosë Shtetet e Bashkuara në një pozitë të pafavorshme në përballje me një fuqi tjetër, teorikisht më të dobët.

Një shembull i mirë i kësaj ndodhi gjatë Luftës së Parë Botërore, përpara se Shtetet e Bashkuara të përfshiheshin në luftë dhe kur Woodrow Wilson përpjeq të manovronte midis bllokadave britanike dhe sulmeve të nëndetëseve gjermane ndaj transportit transatlantik, duke u përpjekur me dëshpërim të ruante neutralitetin amerikan.

Në atë kohë, SHBA ishte shumë më pak e varur nga tregtia ndërkombëtare; ajo përbënte vetëm 11 për qind të PBB-së. Por, siç mësoi Wilson, edhe dëmi në sektorë të veçantë të ekonomisë mund të sillte trazira politike.

Megjithëse, fjala vjen, ai personalisht anonte nga britanikët, kërcënimet e Londrës për të përfshirë pambukun si kontrabandë lufte tërbuan bazën kryesore elektorale të demokratëve në

jug. Sekretari i Thesarit, William Gibbs McAdoo, kujtonte se kishte kaluar “më shumë net pa gjumë duke menduar për pambukun” sesa për çdo gjë tjetër gjatë kohës së tij në detyrë. Netët e tjera pa gjumë i kalonte duke u shqetësuar për gjetjen e tregjeve për grurin e rajoneve të Midwestit, një pjesë e madhe e të cilit ishte blerë nga Gjermania dhe vende të tjera europiane para shpërthimit të luftës.

Këta sektorë specifikë, për shkak se përfshinin shtete dhe rajone që ishin thelbësore për koalicionet politike kombëtare, kishin një ndikim në vendim-marrjen amerikane, që i tejkalonte përmasat e tyre reale në ekonominë amerikane.

Trump me siguri beson, ashtu si Jefferson dikur, se bota ka më shumë nevojë për Amerikën sesa Amerika për botën – dhe mund të ketë të drejtë, të paktën në teori.

Problemi është se blloqet e veçanta votuese kanë më shumë rëndësi për të sesa ndjekja e një lufte tregtare, siç e ka treguar vazhdimisht gjatë të dy mandateve të tij.

Në mandatin e tij të parë, dëmi që iu shkaktua fermerëve nga tarifat mbi importet ishte politikisht aq i madh sa që ai u detyrua të shpenzonte një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave nga tarifat, për t’u kompensuar atyre humbjet. Hezitimet dhe ndryshimet në valët më të fundit të tarifave këtë vit kanë qenë po ashtu të motivuara nga dëshira për të mos larguar votuesit

republikanë në shtete të caktuara – shtete veriore që mbështeten shumë tek tregtia me Kanadanë dhe shtete me industri automobilistike, që do të pësonin humbje të mëdha nga tarifat mbi pjesët e makinave, çelikon dhe aluminin që vijnë nga Meksika dhe Kanada.

Nuk është rastësi që ndër tarifat e para “hakmarrëse” nga europianët ishin ato kundër Harley-Davidson dhe uiskit amerikan.

Kombet e tjera mund të njohin më mirë historinë sesa Trump dhe e kanë kuptuar se vendosja e tarifave mbi sektorët e ekonomisë që godasin votuesit e Trump-it, mund të ketë ndikim përtej vlerës së tyre ekonomike. Shtetet e Bashkuara janë një vend i ndarë politikisht pothuajse më dysh, prandaj grupet marginale të votuesve mund të kenë një efekt të madh. Kjo e dobëson ndjeshëm avantazhin e Amerikës.

Do të ishte ndryshe, nëse mbështetësit e Trump-it do të ishin të gatshëm të duronin vështirësi ekonomike për të treguar përkushtimin ndaj filozofisë MAGA.

Siç e tha senatori Tommy Tuberville nga Alabama: “Do të ketë pak dhimbje me tarifat,” por “pa dhimbje, s’ka fitime.”

Por problemi për Trump-in është se, deri më tani – ashtu si në të kaluarën – edhe vetë votuesit e tij nuk tregojnë shumë durim për të përballuar dhimbje. / The Atlantic – Bota.al

LUFTA TREGTARE E TRUMPIT PO I HAP KINËS DYERT E EVROPËS

Si një spektatore shumë e interesuar e manovrave të mëdha kontinentale (Groenlanda, Panamaja, Kanadaja) dhe evropiane të administratës së re amerikane, Kina pyet veten: deri ku mund të shkojë (tentativa për) një afrim ruso-amerikan? A do ta rihapë ftohja e re transatlantike nga ana e Uashingtonit shtegun e ngatërruar evropian të Rrugës së Mëndafshit? Sa më shumë do ta vinte kjo e para në vështirësi Kinën, aq më shumë e dyta do të përziante kartat në lojë. Në lojën e tregtisë ndërkombëtare, do ta kthente Pekinin në kampion të liberalizimit të shkëmbimeve tregtare. Një mesazh që ministrat e ndryshëm kinezë nuk lodhen së përsërituri, që nga konferenca e Davosit. Një luftë tregtare SHBA-BE mund të bëjë që veshi evropian të bëhet më i ndjeshëm. Prej nevojës, jo se do.

Kina – dhe nuk ankohet për këtë – nuk ka qenë deri tani në qendër të vëmendjes së Donald Trump-it. Vëmendja e tij në politikën e jashtme është përqendruar mbi Rusinë dhe, në plan të dytë, mbi Ukrainën. Për presidentin amerikan, Zelensky është thjesht një mjet në marrëdhënien që ai dëshiron të ndërtojë me Putinin, objektivin e tij të vërtetë, ndërsa evropianët janë lënë në sallën e pritjes.

Po a nuk është Kina rivali i madh global i Shteteve të Bashkuara?

Po, Pekini është goditur me dy raunde tarifash 10%, një kosto e rëndë për një ekonomi që varet në masë të madhe nga eksportet, ndaj së cilës ka reaguar me kundërmasa të përafërta. Por përplasja, edhe në nivel retorik, është ndalur aty. Ndërkohë që Trumpi nuk ka kursyer shigjeta ndaj Bashkimit Evropian, Kanadasë dhe aleatëve aziatikë si Japonia dhe Koreja e Jugut.

E papërmendur ndonjëherë si armik direkt nga administrata Trump, Kina padyshim është gëzuar për ftohjen e ndjeshme të marrëdhënieve mes Uashingtonit dhe Taipeiit. Politika amerikane ndaj Tajvanit mbetet e bazuar në “ambiguitetin strategjik”, domethënë të mos thuhet se çfarë do të bëhej në rast të një agresioni kinez ndaj ishullit – theksi është gjithnjë e më shumë te ambiguiteti, e më pak



te strategjia. Nga ana e vet, Pekini po intensifikon manovrat ushtarake rreth Tajvanit, pa provokuar reagime aq të forta sa ato të administratës Biden. Duke parë përtej, nuk mund të mos vërejë se në rihapjen e dialogut me Moskën kontribuojnë edhe ata që mendojnë se në këtë mënyrë mund të shkëputet, ose të paktën të largohet, Rusia nga Kina. Për t'u përqendruar më pas te rivali i vërtetë – Kina. Një operacion mbi kurrizin e Ukrainës, por presidenti transaksional Trump nuk ka shumë skrupuj. A nuk është i gjithë libri i tij “arti i marrëveshjes”, i mbështetur mbi këtë?

“Realistët” e politikës së jashtme janë skeptikë. Jo sepse miqësia ruso-kineze është “pa kufij”. Kufijtë ekzistojnë, por lidhjet janë strukturore, me një varësi të fortë ekonomike të Moskës nga Kina. Sidoqoftë, nuk është një skenar që Pekini mund ta injorojë, sado siguri t'i japë Vladimir Putini mikut të tij Xi Jinping. Mënyra më e mirë për ta përballuar këtë situatë do të

ishte përfshirja në lojën që po luhet në Europë, pra në Ukrainë. Ja pra që pas muajsh heshtjeje të shurdhër – përveç disa banaliteteve për “të ndalur konfliktin” – nga Pekini papritur vijnë sinjale gatishmërie për të marrë pjesë në një forcë të ardhshme paqeruajtëse.

Le të lëmë mënjanë çështjen se sa e realizueshme është kjo, nëse mund të përkufizohet si një forcë ndërmjetësimi neutrale (“paqeruajtësit”) apo si një garanci ndërkombëtare për një Ukrainë të pavarur nga agresionet e ardhshme ruse, e cila do të duhej të ofrohej nga aleatët e Kievit (zgjidhja “koreane”). Pjesëmarrja kineze do të mund të hynte vetëm në rastin e parë, ndoshta e pranueshme për Moskën. Por kjo i përket të ardhmes së mundshme.

Në të tashmen, duke shprehur gatishmërinë për një rol pas konfliktit në Ukrainë, Pekini synon të vendosë një këmbë në Evropë, pikërisht duke u lidhur me “marrëveshjen” ruso-amerikane. Me një qëllim të dyfishtë: të mos përjashtohet nga Moska dhe Uashingtoni,

dhe të vendosë një marrëdhënie strategjike me Kievin dhe, mbi të gjitha, me Evropën.

Për këtë të fundit, Pekini ka kohë që synon në fushën ekonomike, teknologjike dhe tregtare. Por rruga është e vështirë.

Marrëveshja për investime BE-Kinë e vitit 2020, e mbështetur fort nga Angela Merkel, ka dështuar, ndërkohë që në Bruksel Kina shihet gjithnjë e më shumë si një “konkurrent i pandershëm”, siç e tregon vendosja e tarifave nga BE vitin e kaluar për makinat elektrike kineze.

Qasja për “minimizimin e rrezikut” që vjen nga Kina, në përputhje me atë amerikane, nuk ka ndryshuar, edhe pse pritet që administrata e re amerikane të kërkojë nga evropianët të shtrëngojnë edhe më shumë frenat. Por gjithçka mund të bëhet në një frymë bashkëpunimi transatlantik. Gjithsesi, bëhet më problematike në një klimë lufte tregtare SHBA-BE, si ajo në të cilën mund të gjendemi që nga mesi i prillit. Mund të ndodhë që të dilet nga kjo situatë

përmes negociatash – do të kishim dashur të negocionim para se të shkëmbenim tarifa dhe kundërmasa, BE-ja e ka provuar në çdo mënyrë të mundshme, por Uashingtoni, ose më saktë presidenti amerikan, kërkon më parë luftën dhe vetëm pastaj, ndoshta, paqen. Pra më parë tarifën, pastaj negociatat. Por nëse lufta mbetet, me një Donald Trump që beson ideologjikisht në fuqinë “shëruese” të tarifave, Evropa do të gjendet e shtyrë të kërkojë një marrëveshje tregtare me Kinën.

E cila nuk pret gjë tjetër.

Loja e “tre letrave” e Henry Kissinger-it largoi Pekinin nga Moska në vitin 1972. Sot në Uashington ka nga ata që mendojnë ta përsërisin këtë manovër në drejtim të kundërt. Por pasojë e padëshiruar mund të jetë afrimi i Brukselit me Pekinin dhe lënia e Uashingtonit në izolim. Ndoshta përtej oqeanit mungon një Kissinger që të mendojë për këtë. / Stefano Stefanini (La Stampa – Bota.al)



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Gjermania kualifikohet në gjysmëfinale të Ligës së Kombeve

DORTMUND, 23 MARS - Gjermania dhe Italia kanë barazuar me rezultat 3-3, në një ndeshje spektakolare, por gjermanët kaluan në gjysmëfinale, pasi që edhe në ndeshjen e parë kishte fituar me rezultat 2-1. Joshua Kimmich hapi ndeshjen nga

pika e bardhë në minutën e 30-të të ndeshjes, duke i dhënë pancerëve lehtësi për pjesën e mbetur të ndeshjes. Goli i dytë ishte i çuditshëm, pasi që Gjermania fitoi goditje këndi, ndërsa lojtarët italianë ishin duke u ankuar, Kimmich harkoi

në zonë, ku Musiala i vetëm shënoi për 2-0. Pa u mbyllur pjesa e parë, Tim Kleindienst shënoi për Gjermaninë, duke e quar rezultatin në 3-0 dhe duke i lënë pak gjasa Italisë për më shumë. Me të filluar pjesa e dytë, Italia e gjeti golin e parë,

me Moise Kean që shënoi për 3-1. Sulmuesi shënoi sërish në minutën e 69-të, duke e hapur ndeshjen në 3-2. Por deri në fund nuk kishte gola të tjerë dhe Gjermania me rezultat të përgjithshëm prej 5-4 kaluan tutje.



Kosova shkruan histori, ngritët në Ligën B

“Epoka e re”

PRISHTINË, 23 MARS - Kombëtarja e Kosovës ka arritur suksesin më të madh deri më tash pas pranimit në UEFA e FIFA, duke u ngjitur për herë të parë në Ligën B të Ligës së Kombeve. Dardanët e vulosën këtë arritje të madhe pas një paraqitjeje të shkëlqyer në dy ndeshjet e “play-off”-it ndaj Islandës. Pas fitores 2:1 në sfidën e parë në stadiumin “Fadil Vokrri”, ekipi i drejtuar nga Franco Foda triumfoi edhe në ndeshjen e kthimit në Murcia të Spanjës me rezultat 3:1, duke siguruar një fitore të përgjithshme 5:2. Vedat Muriqi ishte figura kryesore e kësaj fitoreje të madhe. Sulmuesi prizrenas realizoi të tre golat e Kosovës në ndeshjen e kthimit, duke udhëhequr ekipin drejt këtij suksesi historik. Ndeshja



nisi me disavantazh të hershëm për Kosovën, pasi Islanda kaloi në epërsi që në minutën e 2-të me golin e Orri Oskarssonit. Megjithatë, ekipi ynë reagoi fuqishëm. Në minutën e 35-të, Muriqi barazoi

rezultatit pas një aksioni të bukur të Leart Paqaradës. Vetëm pak çaste para përfundimit të pjesës së parë, në minutën e tretë të kohës shtesë, Muriqi realizoi golin e dytë pas një asistimi të Milot

Rashicës. Në pjesën e dytë, Kosova vazhdoi të kontrollonte lojën. Portieri Amir Saipi bëri një pritje vendimtare, ndërsa moment i rëndësishëm në ndeshje ishte ai i minutës së 69-të, kur kapiteni islandez Aron

Gunnarsson u ndëshkua me kartonin e dytë të verdhë, duke lënë skuadrën e tij me një lojtar më pak. Kosova e shfrytëzoi këtë epërsi numerike dhe në minutën e 79-të, Muriqi realizoi golin e tretë pas një asisti të Lindon Emërllahut, duke vulosur fitoren 3:1 dhe kualifikimin në Ligën B. Ky është një moment historik për futbollin e Kosovës, e cila ka bërë një progres të jashtëzakonshëm në Ligën e Kombeve. Pas debutimit në këtë garë në edicionin 2018/19 nga Liga D, Kosova arriti të ngjitej në Ligën C, ku garoi për tre edicione radhazi. Tani, me këtë sukses të madh, ekipi ynë do të jetë pjesë e Ligës B në edicionin 2026/27. Me këtë arritje, Kosova forcon edhe më shumë pozitën e saj në futbollin evropian dhe do të përballlet me kundërshtarë edhe më të fortë në edicionin e ardhshëm të Ligës së Kombeve.

Prishtina fiton dramën ndaj Trepçës, Vëllaznimi dominon në Prizren

“Epoka e re”

PRISHTINË, 23 MARS - Në një super ndeshje të zhvilluar në Prishtinë dhe dramatike deri në fund, Sigal Prishtina ka fituar derbin e javës së 25-të të ProCredit Superligës ndaj Trepçës me rezultat 85:79 (20:16, 21:23, 22:20, 22:20). Drama e zhvilluar në kryeqytet përfundoi me fitoren e kryeqytetasve. Në Prishtinë u zhvillua një lojë tejet e barabartë ku herë njëra, herë tjetra skuadër kalonte në

epërsi. Te vendasit u dalluan Rašid Mahalbasic me 18 pikë, 9 kërcime dhe pesë asistime dhe Josh Nzeakor me 16 pikë, gjashtë kërcime dhe dy asistime, ndërsa te mysafirët u dallua Michael Green III me 19 pikë, katër kërcime dhe tri asistime. Sigal Prishtina ka 16 fitore dhe 9 humbje, derisa Trepça ka 16 fitore dhe 9 humbje. Vëllaznimi shënoi fitore bindëse ndaj Proton Cable Prizrenit si mysafir me rezultat 77:95 (25:19, 8:17, 15:27, 39:32), në kuadër të javës së 25-të të ProCredit Superligës.



Ndeshja nisi më mirë për prizrenasit në “Sezai Surroi”, të cilët fituan pjesën e parë 25:19, ndërsa kuqezinjtë u rikthyen në dhjetëminutëshin e dytë duke dominuar me rezultat 8:17. Më i miri te Proton Cable ishte Tervell Beck me 22 pikë, 14 kërcime, tri asistime, ndërsa te Vëllaznimi u dalluan Atik Koshi me 21 pikë, shtatë kërcime dhe një asistim dhe Trey Anderson me 20 pikë, gjashtë kërcime, një asistim. Proton Cable Prizreni ka 5 fitore e 20 humbje, kurse Vëllaznimi ka 12 fitore e 13 humbje.

Samadrexha e fiton bindshëm derbin me Ferizajn

SUHAREKË, 23 MARS - Samadrexha e ka fituar me dhjetë gola dallim derbin ndaj Ferizajt. Të dielën mbrëma në palestrën “Afrim Bunjaku” në Samadrexhë, skuadra vendase fitoi me rezultat 36:26. Ndeshja i takoi

xhiros së 15-të të Superligës së Kosovës. Që në pjesën e parë Samadrexha krijoi epërsi prej shtatë golave, 17:10. Në të dytën vetëm e konfirmoi fitoren. Mirjeta Dinolli u dallua te Samadrexha me 10 gola. Shtatë i

kishte Bojana Radevska e gjashtë Natalija Milatović. Shkurte Mehmeti ishte më efikasja te Ferizaj me nëntë gola. Shtatë i shënoi Salemateu Camara e katër Luljeta Sopjani. Samadrexha është e treta me 18

pikë. Ferizaj mbetet i dyti me 20 pikë. Të dielën u zhvillua edhe ndeshja Besa - Shqiponja. Fitore me rezultat 33:21 shënoi Shqiponja e Gjakovës. Shqiponja është e katërta me 16 pikë. Besa renditet e shtata me tetë pikë.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 01/2024 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit, lidhur me nenin 33 të Rregullores (ZKA) 03/2024 për Klasifikimin e vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2025 si dhe Vendimit të Auditorës së Përgjithshme me Nr.275 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS
për plotësimin e vendit të lirë të punës

Pozita:	Specialist i mbështetjes për sisteme
Numri i referencës:	SM/ZKA/03-03/25
Grada:	ZKA-B7
Numri i pozitave:	Një (1)
Kohëzgjatja e emërimit:	Me kohë të pacaktuar

Detyrat Kryesore:

- Ndihmon në menaxhimin e sistemit elektronik të menaxhimit të auditimit dhe sistemeve tjera në ZKA;
- Ofron mbështetje për personelin e ZKA-së, nga fusha e sistemeve softuerike;
- Publikon raportet dhe informacionet tjera ne Web faqen e ZKA-së;
- Ndihmon në menaxhimin e roleve të përdoruesve të sistemeve të brendshme;
- Mbështet Administratorin e bazës së të dhënave në menaxhimin e bazës së të dhënave të sistemeve të brendshme të ZKA-së;
- Përpilon raporte ad-hoc nga baza e të dhënave dhe azhurnon shabllonet e dokumenteve sipas kërkesave;
- Shërben si help-desk për çdo kërkesë apo ndihmë që paraqitet nga personeli i ZKA-së në lidhje me sistemet e brendshme;
- Menaxhon me detyra administrative që lidhen me mbështetjen e sistemeve në ZKA;
- Kryen edhe detyra të tjera sipas kërkesës dhe nevojave ne ZKA.

Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:

- Arsimimi: Diplomë fakulteti në inxhinieri, shkencat kompjuterike apo sisteme të informacionit;
- Përvoja profesionale: Tre (3) vite përvojë pune profesionale në analizë dhe përkrahje të aplikacioneve si dhe përpunimin e të dhënave;
- Preferohet certifikim nga fusha e Teknologjisë së informative ne Excel SQ, Python;
- Preferohet njohuri e gjuhës angleze.

Shkathësitë e kërkuara:

- Njohuri të akteve juridike të aplikueshme lidhur me teknologjinë e Informacionit ne Kosovë;
- Shkathësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Njohuri elementare në menaxhimin e projekteve dhe të vlerësimit të ndikimit të projekteve;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Te jete punonjës në ekip.

Informata të përgjithshme për kandidatët:

Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **08.04.2025 ora 16.00**.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. “Ahmet Krasniqi” nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U skladu sa članom 15.2 Zakona 05/L-055 o Generalnom Revizoru i Nacionalne Kancelarije Revizije Republike Kosova, kao i Člana 5, 6 i 7 Uredbe (NKR) 01/2024 o prijemu i Karijeru u Nacionalnoj Kancelariji Revizije, vezano sa Članom 33 Pravilnika (NKR) 03/2024 o Klasifikaciji radnih mesta; Godišnjem planu regrutacije za 2025. godinu, kao i Odlukom Generalne revizorke br.275, za popunu slobodnog radnog mesta Nacionalna Kancelarija Revizije objavljuje:

KONKURS
za popunjavanje slobodnog radnog mesta

Pozicija:	Specijalista podrške za sisteme
Referentni broj:	SM/ZKA/03-03/25
Rang:	ZKA-B7
Broj pozicija:	Jedna (1)
Trajanje imenovanja:	Na neodređeno vreme

Glavni zadaci:

- Pomaže u upravljanju elektronskim sistemom za upravljanje revizijama i drugim sistemima u NKR-u;
- Pruž a podršku osoblju NKR-a u oblasti softverskih sistema;
- Objavljuje izveštaje i druge informacije na veb sajtu NKR-a;
- Pomaže u upravljanju rolama korisnika unutrašnjih sistema;
- Podržava administratora baze podataka u upravljanju bazom podataka unutrašnjih sistema NKR-a;
- Priprema ad-hoc izveštaje iz baze podataka i ažurira šablone dokumenata prema zahtevima;
- Služi kao help-desk za svaki zahtev ili pomoć koja se traži od osoblja NKR-a u vezi sa unutrašnjim sistemima;
- Upravljanja administrativnim zadacima vezanim za podršku sistemima u NKR-u;
- Obavlja i druge zadatke prema zahtevima i potrebama NKR-a.

Opšti formalni zahtevi za ovu radnu poziciju su:

- Obrazovanje:Fakultetska diploma u inženjerstvo, računarske nauke ili informacionih sistema;
- Profesionalno iskustvo: Tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva u analizi aplikacija i podršci, kao i obradi podataka;
- Poželjna je sertifikacija iz oblasti informacionih tehnologija u Excel SQ, Python.
- Poželjno je poznavanje engleskog jezika.

Potrebne veštine:

- Poznavanje zakonskih akata koji se odnose na informacione tehnologije na Kosovu;
- Veština u komunikaciji i planiranja rada;
- Osnovno znanje o upravljanju projektima i proceni uticaja projekta;
- Sposobnost ispunjavanja zadataka i rada pod pritiskom;
- Da bude radnik u timu.

Opšte informacije za kandidate:

Određivanje plate vrši se u skladu sa važećim zakonima.

Postupak prijave:

Postupak prijave je otvoren za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna Kancelarija Revizije nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Kosova i kandidatima iz svih zajednica na Kosovu.

Kandidati trebaju predati sledeća potrebna dokumenta:

- službeni formular NKR-a za aplikaciju;
- kopiju lične karte Republike Kosovo;
- dokaz o školskoj spremi (fakultetska diploma). Diplome dobijene van Kosova moraju biti overene kod notara;
- dokaz o radnom iskustvu (Ugovor o radu ili Dokaz o radnom odnosu, uz dokaz iz Penzionog fonda);
- potvrda iz suda da nije pravosnažno osuđivan (ne starije od šest meseci);
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa javne funkcije (ako se primenjuje);

Samo službeni obrazac za konkurisanje će se uzimati u obzir. Dokumenta dostavljena nakon isteka roka se ne razmatraju a nepotpuna će biti odbijena. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume. Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja na elektronskim medijama (onlajn) i na internet stranici Nacionalne Kancelarije Revizije. Zadnji rok za podnošenje dokumentacije **08.04.2025 do 16.00 časova**.

Obrasci za aplikaciju mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i dostavljaju se u Odeljenju za administriranje dokumenata Nacionalne Kancelarije Revizije na adresi: Naselje: Arbëria, ul. “Ahmet Krasniqi” br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, Obrazac i prateća dokumenta se takođe mogu dostaviti e-poštom na rekrutimi@oagks.org ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete se obratiti na br.tel. 038/606-004, ext:1025.

Beleška:

Aplikacije poslate poštom, koje imaju poštanski žig na uručanju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete na razmatranje.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



Lume's Details

Estetik & Depilim



 044 900 978 | 045 681 898

 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Akicuki Group” SH.P.K. me seli në Vushtri, Ardian Shallci ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812236637 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Akicuki Group” D.O.O. Vushtri, Ardian Shallci donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812236637 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Akicuki Group” L.L.C. with headquarters Vushtri, Ardian Shallci has come to the decision to quit its business: 812236637 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- “Lirimi” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810775562.

- Jeton Demiri shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore nga klasa 1 deri 8 "Zenum Çoçaj" në Gjonaj.

- Avdi Arifi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Visar Junuzi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë, drejtimi Tregti.

- Marash Dedaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 të sh.m. Mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Erëblina Zymberi nga Gjakova shpall të pavlefshgme dëftesat e kl. 10.11.12. si dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Behar Q. Mehmeti B.I. shpall të pavlefshme nr. Unik të Biznesit: 812091437 të lëshua nga ARBK.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas mar-

rëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

